

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018“), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

KONKURS

për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI EKONOMIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Marketingu në turizëm
 - Marketing menaxhment
 - Bazat e marketingut.
2. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Makroekonomia
 - Ekonometri
 - Ekonomi e investimeve.
3. Një mësimdhënës për lëndët:
 - E-marketing
 - Etika afariste
 - Komunikimi afarist.
4. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat e ekonomisë
 - Ndërmarrësi
 - Menaxhimi i biznesit të vogël.

FAKULTETI PEDAGOGJIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - Pedagogjia e kohës së lirë
 - Didaktika I dhe II
 - Metodika e punës së pedagogut të shkollës me praktikë pedagogjike.
2. Dy mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e pedagogjisë.
3. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e arsimimit të mësimdhënësve.
4. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e matematikës (Metodika e matematikës), në programin studimor Mësim Klasor.

FAKULTETI FILOZOFIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Psikologji edukimi
- Psikologji zhvillimore
- Psikologji shkollore
- Psikologjia e sjelljes kolektive.

FAKULTETI JURIDIK

1. Një mesimdhënës për lëndët:
 - Kriminologji me Penologji
 - Viktimologjia
 - E drejta penale ndërkombëtare.
2. Një mesimdhënës për lëndët:
 - Kriminalistika
 - Krimi i organizuar
 - E drejta penale.

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE

1. Një mesimdhënës për lëndët:
 - Atletika I
 - Atletika II.

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT

1. Një mesimdhënës për lëndët:
 - Mikrobiologjia e përgjithshme
 - Mikrobiologjia ushqimore.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA

1. Një mesimdhënës për lëndët:
 - Siguria në komunikacionin rrugor
 - Projektimi i infrastrukturës rrugore
 - Teknikat për menaxhimin e komunikacionit.

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

1. Një mesimdhënës për lëndët:
 - Mikrobiologji me parazitologji
 - Epidemiologji.
2. Një mesimdhënës për lëndët:
 - Paradontologji paraklinike
 - Paradontologji klinike
 - Mjekësi orale dhe patologji paraklinike
 - Mjekësi orale dhe patologji klinike.

3. Një mësimdhënës për lëndët në fushën e kirurgjisë kardiovaskulare, kirurgjisë torakale dhe kirurgjisë vaskulare.

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsimin e lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Universiteti i Tetovës